





# COVID-19

Informacion i përgjithshëm





Për më shumë informacion kontakto  
[covid19health.gov.mt](https://www.covid19health.gov.mt)

© 2020

## Çfarë janë Koronavirusët?


Koronavirusët janë një familje e madhe që shkaktojnë sëmundje me simptoma të ndryshme që variojnë nga një ftohje e thjeshtë deri në komplikacione më të rënda. Virusi përgjegjës për COVID-19 është një lloj i ri virusi i kësaj familjeje.

## Cilat janë simptomat e COVID-19?

**Simptomat më të zakonshme janë:**



**temperaturë dhe/ose**



**kollë dhe/ose**



**veshtirësi  
në frymëmarrje**

## Sa kohë duhet për shfaqjen e simptomave?

Periodha e inkubimit, koha që duhet nga ekspozimi ndaj virusit deri në shfaqjen e simptomave të para, varion midis 2 deri në 14 ditë.

## Si shpërndahet koronavirusi COVID-19?

COVID-19 transmetohet nga personi në person nëpërmjet pikëzave që dalin nga rrugët e frymëmarrjes, hunda ose goja, kur një person i sëmurë me COVID-19 kollitet ose tështitet.

Këto pikëza qëndrojnë në objektet ose sipërfaqet rreth personit të sëmurë. Infektimi me COVID-19 ndodh, kur ju prekni këto objekte ose sipërfaqe dhe më pas prekni sytë, hundën ose gojën. Infektimi me COVID-19 mund të bëhet edhe nëpërmjet frymëmarrjes në rast se një person i sëmurë pranë jush tështitet ose kollitet. Prandaj është e rëndësishme që një person i sëmurë të qëndrojë në shtëpi, të mbajë një distancë prej së paku dy metrash nga të tjerët dhe të respektojë rregullat e higjenes.

## Ekziston kurë ose vaksinë?




Nuk ekziston kurë specifike për COVID-19. Për momentin, ilaçet që jepen nga doktori janë kura suporti që ndihmojnë për të kontrolluar dhe lehtësuar simptomat.

Për momentin, nuk ekziston një vaksinë për COVID-19. Prandaj, është e rëndësishme të parandalohet infektimi ose shpërndarja e virusit nga një person i prekur nga COVID-19 tek të tjerët.

## Si mund të mbroj veten?

**Që të mbroni veten dhe të tjerët, praktikoni një higjenë të mirë të duarve dhe frymëmarrjes:**

- ✓ Laj duart rregullisht me ujë dhe sapun për të paktën 20 sekonda. Kur kjo nuk është e mundur përdor një dezinfektant me përbërje alkooli.
- ✓ Mbulo hundën ose gojën me shami letre ose përdor pjesën e brëndshme të brrylit kur kollitesh ose tështin. Hidhi shamitë e letres në koshin e plehrave menjëherë pas përdorimit.
- ✓ MOS tështi dhe mos u kollit në duar sepse mund të kontaminosh objektet ose njerëzit që prek më pas.
- ✓ Shmang prekjen e syve, hundës dhe gojës nese nuk ke lare më parë duart.
- ✓ Mbjaj një metër distancë kur flet me dikë ose dy metra distance nga një i sëmurë.
- ✓ Rri në shtëpi sa më shumë të jetë e mundur. Evito turmat ose vendet ku mblidhen shumë njerëz.
- ✓ Qëndro larg personave më të rrezikuar, të moshuarve dhe atyre që kanë sëmundje të tjera ekzistuese.



## Çfarë është karantina?

Karantina nënkupton vetëizolimim në shtëpi, qëndrimin brenda gjatë gjithë periudhës 14-ditorëshe që ju kërkohet të jeni të izoluar. Mos lejoni vizitorë në shtëpi. Personat në karantinë duhet të monitorojnë temperaturën dy herë në ditë.

## Kush duhet të nënshtrohet karantinës së detyruar?

Personat që hyjnë në Maltë pasi kanë udhëtuar jashtë, nga çdo destinacion, duhet të hyjnë në karantinë të detyruar për një periudhë 14 ditore nga data e kthimit. Personat e identifikuar nga Autoriteti i Shëndetit Publik si të afërm të personave të sëmurë, duhet gjithashtu të nënshtrohen karantinës së detyruar 14 ditore.



Personat që nuk respektojnë karantinën e detyruar do gjobiten me €3000 çdo herë që kapen duke thyer këtë urdhër.

## A do të thote kjo që familjarët ose ata me të cilët jetoj, duhet të nënshtrohen karantinës?

Po, personat e tjerë që jetojnë me ju duhet gjithashtu të nënshtrohen detyrimisht karantinës.

**Për më tepër udhëzime rreth karantinës vizito**  
**[covid19health.gov.mt](https://www.covid19health.gov.mt)**

**Për më tepër suport rreth karantinës telefono**  
**21 411 411**

## Përse është kaq e rëndësishme të rrih në shtëpi

Qëndrimi në shtëpi mbron miqtë e tu, kolegët dhe komunitetin. Ndhmon gjithashtu kontrollimin e shpërndarjes së virusit. Qëndrimi në shtëpi mund të jete i vështirë ose frustrues, por ka aktivitete që mund ta bejnë këtë periudhë më të lehtë. Disa prej tyre janë:

- ✓ Kërkoji miqve ose familjarëve t'iu sjellin çfarë keni nevojë ose bëni porosi online. Nëse kjo nuk është e mundur, telefononi 21 411 411 për asistencë. Sigurohuni që dërgesat të lihen jashtë deres tuaj për të evituar çdo kontakt.
- ✓ Mbani lidhje me miqtë ose familjen nëpërmjet telefonit ose mediave sociale.
- ✓ Mbusheni kohën tuaj me aktivitete, gatvani, lexoni, mësoni online ose shikoni filma.
- ✓ Filloni nje kurs online për të nxitur aktivitetin fizik në kushte shtëpie.

## Çfarë duhet të bëj nëse shfaq simptoma?

Nëse konstatoni temperaturë, kollë ose vështirësi në frymëmarrje:

- ✓ Qëndroni në shtëpi
- ✓ MOS shkoni në klinika private, urgjencën e spitalit, qendrat shëndetësore, farmaci ose institucione të tjera shëndetësore.
- ✓ Telefononi linjën e ndihmës së **Shëndetit Publik 111** për këshillim.

Personat që shfaqin simptoma të COVID-19 janë të lutur të mos vizitojnë doktorë për konsultë, qendra shëndetësore ose urgjencën spitalore, por të **telefonojnë numrin e ndihmës për COVID-19 në 111**. Personat që shfaqin simptoma do vlerësohen individualisht përpara se të vendoset mbi testimin . Testi bëhet vetëm me takim të paracaktuar.